

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.01.02.2023*

01.02.2023
Ora 10:34

RENDI I DITËS

Projektakti “Për zbatimin e projektit pilot për procesin e votimit dhe numërimit elektronik të votave, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 Maj 2023, në bashkitë Elbasan, Kamëz dhe Vorë”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 2. Staf i KQZ: **Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja,
Znj. J. Josifi**
- **Parti Politike:** **PDIU**
- **Të tjerë:** **KRIIK**

Z. I. Celibashi: Mirëdita të gjithëve! Atëhere në seancën e sotme publike kemi në rendi dite këto çështje për të shqyrtuar: Projektvendimi “Për zbatimin e projektit pilot për procesin e votimit dhe numërimit elektronik të votave, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 Maj 2023, në bashkitë Elbasan, Kamëz dhe Vorë”. Projektvendim “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të akreditimit të vëzhguesve të subjekteve zgjedhore në komisionet e zonave të administrimit zgjedhor, komisionet e qendrave të votimit dhe vendet e numërimit të votave në zgjedhje”. Pikat në vazhdim lidhen me plotësimin e vakancave në këshillat bashkiak të bashkive Librazhd, Durrës, Berat, Dibër. Pika e fundit e rendit të ditës lidhet me vlerësimin e veprimtarisë së disa insitucioneve publike gjatë periudhës nga 13 Janar deri në 14 Maj. Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.01.02.2023

që ka të bëjë me projektvendimin “Për zbatimin e projektit pilot për procesin e votimit dhe numërimit elektronik të votave, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 Maj 2023, në bashkitë Elbasan, Kamëz dhe Vorë”.

Z. Y. Merkaç: Referuar nenit 19, pikat 1, shkronja "n" dhe 2 të Kodit Zgjedhor, si dhe vendimit nr. 4, datë 13.11.2020, të Komisionit Rregullator, "Për llojin dhe karakteristikat teknike që duhet të plotësojnë sistemet dhe pajisjet e votimit dhe numërimit elektronik që prokurohen në Republikën e Shqipërisë", kërkohet përcaktimi i zonës zgjedhore ku do të zbatohet projekti pilot i votimit dhe numërimit elektronik. Projekti pilot i votimit dhe numërimit elektronik u zbatua për herë të parë në zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021, në ZAZ nr. 40, Qarku Tiranë, si dhe në zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie, të datës 6 Mars 2022, në bashkinë Vorë. Pas pilotimit të suksesshëm në dy rastet e sipërpërmendura, propozohet që projekti pilot për procesin e votimit dhe numërimit elektronik të zbatohet edhe për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023. Për këtë KQZ kishte konsideruar shtrirjen e këtij projekti, veçmas bashkisë Vorë, edhe në 6 bashki të tjera. Për këtë qëllim KQZ i kërkoi Këshillit të Ministrave dhe Kuvendit të Shqipërisë një fond në vlerën e 3 miliard e 236 milion e 364 mijë e 70 Lekë. Nëpërmjet Ministrisë së Financave, KQZ ka marrë njoftimin, se Këshilli i Ministrave ka miratuar një fond në vlerën e 800,000,000 Lekë (800 milion lekë) për zgjerimin e votimit elektronik në zgjedhjet e datës 14 maj 2023. Në përputhje me fondin e vënë në dispozicion konkludojmë se ai është i mjaftueshëm për zhvillimin e votimit elektronik në rreth 350 qendra votimi, veçmas bashkisë Vorë. Duke marrë në konsideratë këtë numër qendrash votimi, kohën në dispozicion të realizimit të këtij projekti, si dhe dobinë për zhvillimin e tij në ambiente gjeografike të ndryshëm rekomandohet zhvillimi i

Zbardhi materialin audio

Ardita ÇAMI



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.01.02.2023*

votimit elektronik të bëhet edhe në bashkitë Elbasan dhe përkatësisht ZAZ 47, 48, 49, 50 të cilat kanë në administrim 222 QV dhe për bashkinë Kamëz në ZAZ 27 dhe 28; të cilat kanë në administrim 130 QV. Si dhe për bashkinë Vorë, përkatësisht ZAZ 26. Në zbatim të nenit 22 të Kodit Zgjedhor, ku përcaktohen kompetencat e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve lidhur me teknologjinë në zgjedhje, do të zbatohet e njëjta procedurë për fazën pasuese të implementimit të këtij projekti në Bashkitë Elbasan, Kamëz dhe Vorë në zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore të datës 14.05.2023. Për sa më sipër në këtë relacion paraqesim për shqyrtim dhe miratim projektvendimi “Për zbatimin e projektit pilot për procesin e votimit dhe numërimit elektronik të votave, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023 në bashkitë Elbasan, Kamëz dhe Vorë”.

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Nga përfaqësues të partive politike? Nuk kemi ndonjë koment.

Z. Y. Merkaç: I është shpërndarë partive për njohje të materialit, nuk kemi pasur deri tani ndonjë koment.

Z. I. Celibashi: Dakord! Miratojmë projektvendimin sipas draftit të paraqitur.

Vendimi nr. 22

Zbardhi materialin audio

Ardita ÇAMI



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.01.02.2023*

01.02.2023
Ora 10:38

RENDI I DITËS

Projektakti “Për miratimin e procedurave dhe kritereve të akreditimit të vëzhguesve të subjekteve zgjedhore në komisionet e zonave të administrimit zgjedhor, komisionet e qendrave të votimit dhe vendet e numërimit të votave në zgjedhje”.

PJESËMARRJA :


- **KQZ**
 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 2. Stafi KQZ: **Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja,
Znj. J. Josifi**
- **Parti Politike:** **PDIU**
- **Të tjerë:** **KRIIK**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me aktin për vëzhguesit e partive politike, subjekteve zgjedhore në komisionet e niveleve të dyta dhe të treta.

Z. Y. Merkaj: Kodi Zgjedhor përcakton në nenin 6 dhe 7 të tij të drejtën e çdo subjekti zgjedhor për të caktuar vëzhgues në KZAZ, QV dhe VNV. Gjithashtu neni 19 pika 1 shkronja “n” e Kodit Zgjedhor ka parashikuar kompetencën e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për të ushtruar në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkojnë asaj me ligje të veçanta si dhe çdo kompetencë që ky ligji nuk ia njeh shprehimisht Komisionit Rregullator. Për këtë arsye kemi

Zbardhi materialin audio

Ardita ÇAMI



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.01.02.2023*

paraqitur projektvendimin e mësipërm. Qëllimi i këtij projektvendimi është përcaktimi i procedurave dhe kritereve të akreditimit të vëzhguesve të subjekteve zgjedhore në Komisionin e Zonës së Administrimit Zgjedhor (ZAZ), Komisionin e Qendrës së Votimit (KQV) dhe në Vendin e Numërimit të Votave (VNV). Ky projektvendim vjen në përputhje me parashikimet e Kodit Zgjedhor si dhe në reflektim të plotë të rolit dhe rëndësisë së vëzhguesve zgjedhor në çdo fazë të procesit ku ata akreditohen. Përcaktimi i procedurave të akreditimit, të drejtat dhe detyrat e vëzhguesve si dhe rregullat tërësore të vëzhgimit të zgjedhjeve mundësojnë përmbushjen me profesionalizëm të detyrës nga ana e tyre. Projektvendimi ka në përmbajtje 13 nene të ndara në 4 Krerë si më poshtë: Kreu i parë parashikon dispozita të përgjithshme. Kreu i dytë përcakton procedura e akreditimit të vëzhguesve në KQZ. Kreu i tretë parashikon akreditimi i vëzhguesve nga KZAZ-ja. Kreu i katërt përfshin dispozitat përfundimtare. Në referim të nenit 6 pika 1 dhe 4 të Kodit Zgjedhor ku përcaktohet se çdo subjekt zgjedhor ka të drejtë të përcaktojë nga një vëzhgues në KZAZ, në QV dhe në çdo tavolinë në VNV pas rregjistrimit të kandidatëve ose kandidatëve në zonën zgjedhore përkatëse ose pasi kanë paraqitur listën shumëmemërore. Në rast se partitë politike paraqiten në zgjedhje si koalicion të drejtën për të përcaktuar vëzhgues e ka vetëm koalicioni. Koalicioni mund të përcaktojë jo më shumë se tre përfaqësues për koalicionin, kandidatët e partive nuk kanë të drejtë të caktojnë vëzhgues, akreditimi i vëzhguesve pranë Komisioneve Zgjedhore bëhet mbi bazën e të dhënave vetjake të çdo vëzhguesi. Akreditimi mund të përfshijë një ose më shumë QV ose një apo më shumë zona zgjedhore. Në zbatim të përcaktimeve të Kodit Zgjedhor Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me udhëzim të veçantë do t'iu delegojë KZAZ-ve kompetencën e akreditimit të vëzhguesve. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim. Faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.01.02.2023*

Z. I. Celibashi: Po zonja Koja.

Zj. M. Koja: Komisioner ditën e sotme Koalicioni për Reformë Integrim dhe Institucione të Konsoliduara, “KRIIK” ka paraqitur disa sugjerime që mendojmë se mund ti shërbejnë përmirësimit të draftit. Konkretisht sugjerimet kanë të bëjnë me detyrat e vëzhguesve në QV më së shumti, sikundër është ndalimi i tyre për të qendruar afër dhomave të fshehta, qëndrimi i tyre në ambiente të QV duke i identifikuar zgjedhësit në mënyra të ndryshme si dhe detyrimi për KZAZ-të për të përcjellë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe dokumentacionin e plotë të akredituarve, pra jo vetëm listën e tyre por edhe dokumentacionin. Ne mendojmë që këto sugjerime qëndrojnë dhe mund ta përmirësojnë aktin, kështu që akti në zbardhje mund të dalë me disa ndryshime duke reflektuar sugjerimet e KRIIK.

Z. I. Celibashi: Përfaqësues të partive politike ndonjë koment? Nuk kemi komente! Dakord, edhe unë vlerësoj që rekomandimet e KRIIK janë të përshtatshme për tu përfshirë në aktin për akreditimin e vëzhguesve të subjekteve zgjedhore pranë KZAZ-ve, KQV-ve, GNV-ve. Kryesisht ato konsistojnë për sjelljen e vëzhguesve në QV. Atëhere, e miratojmë projektaktin me ndryshimet e propozuara nga organizata KRIIK.

Vendimi nr. 23

Zbardhi materialin audio

Ardita ÇAMI



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.01.02.2023*

01.02.2023
Ora 10:43

RENDI I DITËS

Projektakti “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Librazhd me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, zj. Flutur Elmaz Kojku”.

PJESËMARRJA :


- **KQZ**
 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 2. Stafi KQZ: **Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja,
Znj. J. Josifi**
- **Parti Politike:** **PDIU**
- **Të tjerë:** **KRIIK**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës që ka të bëjë me plotësimin e vakancave në këshillat bashkiak të Durrësit, Beratit, Dibrës dhe Librazhd.

Z. Y. Merkaj: Këshilli bashkisë Librazhd ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltari, zj. Elona Agim Koçi, propozuar nga subjekti politik Partia Socialiste e Shqipërisë. Referuar nenit 164, paragrafi 2, të Kodit Zgjedhor, kandidati vijues nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, të cilit i kalon mandati i këshilltarit, është kandidati me numër rendor 13, zj. Flutur Elmaz Kojku. E cila ka depozituar dhe plotësuar formularin e deklaramentit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve me numër unik 4. Nga verifikimi

Zbardhi materialin audio

Ardita Çami



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.01.02.2023*

i formularit të vetëdeklarimit të zj. Flutur Elmaz Kojku, rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe nga zyra e gjendjes gjyqësore ku në përgjigje të shkresës sonë Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, ende nuk ka kthyer ende përgjigje. Ndërsa Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, ka dërguar verifikimin e gjendjes gjyqësore për zj. Flutur Elmaz Kojku, ku konstatohet se kandidati nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë. Në mbështetje të pikës 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë konstatohet se të dhënat e kandidatit për anëtar zj. Flutur Elmaz Kojku, në këshillin e bashkisë Librazhd, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e këshilltarit. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Meqenëse kandidati i rradhës nuk është në kushtet e ndalimit. E miratojmë vendimin për plotësimin e vakancës në këshillin e bashkisë Librazhd me kandidaten Flutura Elmaz Kojku.

Vendimi nr. 24

*Zbardhi materialin audio
Ardita Çami*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.01.02.2023*

01.02.2023
Ora 10:44

RENDI I DITËS

Projektakti “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Durrës me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Demokratia Sociale e Shqipërisë, zj. Ticjana Petraq Verori”.

PJESËMARRJA :

• **KQZ**

1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
2. Staf i KQZ: **Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja,
Znj. J. Josifi**

• **Parti Politike:**

PDIU


• **Të tjerë:**

KRIIK

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës që ka të bëjë me plotësimin e vakancave në këshillit bashkiak të Durrësit.

Z. Y. Merkaj: Këshilli bashkisë Durrës ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltari, z. Nazmi Reshit Bodlli, propozuar nga subjekti politik Partia Demokratia Sociale e Shqipërisë. Referuar nenit 164, paragrafi 2, të Kodit Zgjedhor, kandidati vijues nga lista shumemërore Partisë Demokratia Sociale e Shqipërisë, të cilit i kalon mandati i këshilltarit, është kandidati me numër rendor 2, zj. Ticjana Petraq Verori. E cila ka depozituar dhe plotësuar formularin e deklarimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve me numër unik 57. Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit rezulton se nuk ka deklaruar

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.01.02.2023*


asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe nga zyra e gjendjes gjyqësore. Ku Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, ka dërguar verifikimin e gjendjes gjyqësore ku konstatohet se kandidati nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, ende nuk ka kthyer përgjigje. Në mbështetje të pikës 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë konstatohet se të dhënat e kandidatit për anëtar zj. Ticjana Petraq Verori, në këshillin e bashkisë Durrës, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e saj në funksionin e këshilltarit. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: E miratojmë projektvendimin për zëvendësimin e vendit vakant në këshillin e bashkisë Durrës me kandidaten zonjën Ticjana Petraq Verori.

Vendimi nr. 25

Zbardhi materialin audio

Ardita ÇAMI



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.01.02.2023*

01.02.2023
Ora 10:46

RENDI I DITËS

Projektakti “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Durrës me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, zj. Luljeta Agim Metani”.

PJESËMARRJA :

• **KQZ**

1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**

2. Stafi KQZ: **Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja,
Znj. J. Josifi**

• **Parti Politike:** **PDIU**

• **Të tjerë:** **KRIIK**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës që ka të bëjë me plotësimin e vakancave në këshillit bashkiak të Durrësit.

Z. Y. Merkaj: Këshilli Bashkisë Durrës ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltari, zj. Valbona Hasan Begici, propozuar nga subjekti politik Partia Socialiste e Shqipërisë. Referuar nenit 164, paragrafi 2, të Kodit Zgjedhor, kandidati vijues nga lista shumemërore Partia Socialiste e Shqipërisë të cilit i kalon mandati i këshilltarit, është kandidati me numër rendor 54, zj. Luljeta Agim Metani. E cila ka depozituar dhe plotësuar formularin e deklarimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve me numër unik 1. Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të

**Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publiketë
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.01.02.2023*

dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe nga zyra e gjendjes gjyqësore. Ku në përgjigje të kërkesës sonë Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, ka dërguar verifikimin e gjendjes gjyqësore ku konstatohet se kandidati zj. Luljeta Metani nuk është e dënuar me vendim penal të formës së prerë. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, ende nuk ka kthyer përgjigje. Në mbështetje të pikës 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë konstatohet se të dhënat e kandidatit për anëtar zj. Luljeta Agim Metani në këshillin e bashkisë Durrës, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e saj në funksionin e këshilltarit. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: E miratojmë projektvendimin duke bërë zëvendësimin nga lista shumëmemërore e Partisë Socialiste për kandidatë të Këshillit të Bashkisë Durrës me zonjën Luljeta Agim Metani.

Vendimi nr. 26

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.01.02.2023*

**01.02.2023
Ora 10:47**

RENDI I DITËS

Projektakti “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Durrës me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, z. Arbër Idriz Elmadhi”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 2. Stafi KQZ: **Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja,
Znj. J. Josifi**
- **Parti Politike:** **PDIU**
- **Të tjerë:** **KRIIK**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës!

Z. Y. Merkaj: Këshilli Bashkisë Durrës ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltari, z. Jurgen Luan Dashi, propozuar nga subjekti politik Partia Socialiste e Shqipërisë. Referuar nenit 164, paragrafi 2, të Kodit Zgjedhor, kandidati vijues nga lista shumemërore Partia Socialiste e Shqipërisë të cilit i kalon mandati i këshilltarit, është kandidati me numër rendor 55, z. Arbër Idriz Elmadhi. I cili ka depozituar dhe plotësuar formularin e deklaramit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve me numër unik 5. Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015. Komisioni

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.01.02.2023*

Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe nga zyra e gjendjes gjyqësore. Ku në përgjigje të kërkesës sonë Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, ka dërguar verifikimin e gjendjes gjyqësore z. Arbër Elmadhi ku konstatohet se kandidati nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, ende nuk ka kthyer përgjigje. Në mbështetje të pikës 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë konstatohet se të dhënat e kandidatit për anëtar në Këshillin e Bashkisë Durrës, z. Arbër Elmadhi nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e këshilltarit. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: E miratojmë projektvendimin duke bërë zëvendësimin nga lista shumëmemërore e kandidatit të Partisë Socialiste për Këshillin e Bashkisë Durrës me kandidatin e rradhës zotin Arbër Idriz Elmadhi.

Vendimi nr. 27

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.01.02.2023*

01.02.2023
Ora 10:49

RENDI I DITËS

Projektakti “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Berat me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, z. Gjergj Atem Daja”.


PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 2. Stafi KQZ: **Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja,
Znj. J. Josifi**
- **Parti Politike:** **PDIU**
- **Të tjerë:** **KRIIK**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës!

Z. Y. Merkaj: Këshilli bashkisë Berat ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltari, z. Dragan Tabaku, propozuar nga subjekti politik Partia Socialiste e Shqipërisë. Referuar nenit 164, paragrafi 2, të Kodit Zgjedhor, kandidati vijues nga lista shumemërore Partia Socialiste e Shqipërisë të cilit i kalon mandati i këshilltarit, është kandidati me numër rendor 38, z. Gjergj Daja. I cili ka depozituar dhe plotësuar formularin e deklaramentit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve me numër unik 58. Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.01.02.2023*

ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe nga zyra e gjendjes gjyqësore. Ku në përgjigje të kërkesës sonë Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, ka dërguar verifikimin e gjendjes gjyqësore ku konstatohet se kandidati nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë. Në mbështetje të pikës 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë konstatohet se të dhënat e kandidatit për anëtar në këshillin e bashkisë Berat, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e këshilltarit. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: E miratojmë projektvendimin për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Berat me kandidatin nga lista shumëmemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë zotin Gjergj Atem Daja.

Vendimi nr. 28

Zbardhi materialin audio

Ardita ÇAMI



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.01.02.2023*

01.02.2023
Ora 10:50

RENDI I DITËS

Projektakti "Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Dibër me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, z. Dritan Embrush Salkurti".

PJESËMARRJA :

• **KQZ**

1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**

2. Stafi KQZ: **Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja,
Znj. J. Josifi**

• **Parti Politike:** **PDIU**

• **Të tjerë:** **KRIIK**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës!

Z. Y. Merkaj: Këshilli Bashkisë Dibër ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltari, zj. Alketa Çanaku, propozuar nga subjekti politik Partia Socialiste e Shqipërisë. Referuar nenit 164, paragrafi 2, të Kodit Zgjedhor, kandidati vijues nga lista shumemërore Partia Socialiste e Shqipërisë të cilit i kalon mandati i këshilltarit, është kandidati me numër rendor 20, z. Dritan Salkurti. I cili ka depozituar dhe plotësuar formularin e deklaramentit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve me numër unik 3. Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit rezulton se ka deklaruar ndryshimin në rubrikën e gjeneralitete të më parshme, ka ndryshuar emrin nga Olsi në Dritan. Gjithashtu edhe të dhënat në

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.01.02.2023

gjendjen gjyqësore të personit ka deklaruar se ka në periudhën Nëntor 2011, është ndaluar nga autoritet greke, në Larisa Greqi, për mungesë dokumentacioni, arsye për të cilën deklaroi se është shpallur i pafajshëm. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe nga zyra e gjendjes gjyqësore. Ku në përgjigje të kërkesës sonë Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, ka dërguar verifikimin e gjendjes gjyqësore për z.Dritan Salkurti ku konstatohet se kandidati nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë. Gjithashtu Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile ende nuk ka kthyer përgjigje. Në mbështetje të pikës 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë konstatohet se të dhënat e kandidatit për anëtar në këshillin e bashkisë Dibër zotit Dritan Salkurti, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e këshilltarit. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: E miratojmë projektvendimin për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Dibër me kandidatin e rradhës nga lista shumëmemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë zotin Dritan Embrush Salkurti.

Vendimi nr. 29

Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.01.02.2023*

01.02.2023
Ora 10:52

RENDI I DITËS

Vijim i hetimit administrativ për shkelje të konstatuara për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, qendrore dhe vendore si dhe agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore.

PJESËMARRJA :

• **KQZ**

1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**

2.Stafi KQZ: **Y. Merkaj, M. Koja, J. Josifi**

• **Të tjerë: Bashkia Berat, Dimal, Lushnje, Durrës**

Librazhd, Ministria e Kulturës

Z. I. Celibashi: Atëherë kalojmë tek pika e fundit e rendit të ditës që ka të bëjë me vlerësimin e raportit mbi sjelljen e disa institucioneve publike, në periudhën nga 13 janari në vazhdim.

Znj. M. Koja: Atëherë, ky raportim vjen në vijim të raportimit të herës së kaluar mbi konstatimet e disa shkeljeve, të marra nga faqja e raportimeve në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Nga 18 institucionet e evidentuara me shkelje gjatë procedurës së hetimit administrativ, 12 prej tyre kanë dhënë shpjegim pranë KQZ-së ndërsa 6 nuk kanë dhënë shpjegim deri më sot. Nga 12 përgjigjet e ardhura, ne vlerësojmë se 10 prej tyre qendrojnë si argument dhe kryesisht kanë të bëjnë me ato problematika që ne dhe i referuam me aksesimin në faqe, ndërsa për dy prej tyre mendojmë se argumentet nuk qendrojnë. Konkretisht Ministria e Turizmit dhe

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.01.02.2023*

Mjedisit dhe Bashkia Berat. Ndërkohë nga informacionet që kemi, në seancë ka përfaqësues të institucioneve që mund të japin shpjegimet e tyre. I ftoj që të prezantohen.

Z. I. Celibashi: Mirë, nëse ka përfaqësues nga Ministria e Turizmit dhe nga Bashkia Berat, meqenëse sipas vlerësimit paraprak të bërë nga administrata pretendimet që përfaqësuesit, ose personat përgjegjës për komunikimin me KQZ-në përsa i përket raportimit të veprimtarive, janë gjetur si të pambështetura. Ka përfaqësues nga Ministria e Turizmit apo nga Bashkia Berat? Nuk ka. Kurse për 10 institucionet e tjera në vlerësimin tuaj...

Znj. M. Koja: Qendrojnë argumentet e paraqitura prej tyre.

Z. I. Celibashi: Qendrojnë argumentet justifikuese, të themi, për vonesat që ne kemi gjetur.

Znj. M. Koja: Ndërkohë kemi Bashkinë Dimal, Bashkinë Durrës dhe ndonjë institucion tjetër që kanë ardhur të japin shpjegimet në seancë.

Z. I. Celibashi: Nëse dikush do, por nuk e shikoj të nevojshëm, nëse vlerësimi juaj është që...

Znj. M. Koja: Nuk kanë sjellë përgjigje dhe kanë preferuar të vijnë dhe ti paraqesin sot në seancë.

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.01.02.2023

Z. I. Celibashi: Janë ata që do të flasin për institucionet që nuk kanë dhënë shpjegime me shkresë. Cilat janë 6 institucionet?

Znj. M. Koja: Bashkia Durrës është këtu dhe Bashkia Dimal në dijeninë time, të tjerat...

Z. I. Celibashi: Dakord, po.

Përfaqësues me autorizim i znj. Almiva Llaçi, përfaqësuese e Bashkisë Durrës:
Bashkia Durrës, përfaqësues me autorizim nga zonja Almiva Llaçi që është Shefja e Kabinetit dhe njëkohësisht personi i ngarkuar për të bërë publikimet në ndërfaqe. Bashkia Durrës ka zhvilluar dy, ose ka publikuar në ndërfaqe një ditë para zhvillimit të ativitetit. Më tepër për punët e bashkisë. Njëra është mbjellja e pemëve dhe shtimi i koshave në qytet dhe tjetra është vendosja e ndriçimit të ri në një rrugë të qytetit të Durrësit, rruga “Haziz Shkupi”. Sqarojmë se në postimin e bërë ka vetëm një panoramë të qytetit të Durrësit, nuk ka prononcim të Kryetarit të Bashkisë dhe as premtim elektoral. Është shfaqur vetëm në faqen personale të titullarit të institucionit, në zbatim të funksioneve të Kryetarit të Bashkisë që është neni 23 i ligjit “Për vetqeverisjen vendore”. Nuk kemi pamje të Kryetarit të Bashkisë dhe pjesëmarrje as të shtypit dhe as të qytetarëve. Është munduar disa herë të aksesohet nga personat e ngarkuar dhe nuk ka arritur për shkak të problemeve të sistemit të faqes. Gjykojmë se...

Z. I. Celibashi: Më fal, në cilën datë janë zhvilluar këto 2 veprimtari?

Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.01.02.2023*

Përfaqësues me autorizim i znj. Almiva Llaçi, përfaqësuese e Bashkisë Durrës:
Në 20 dhe në 21 janar.

Z. I. Celibashi: Ju e keni bërë raportimin 1 ditë më përpara.

Përfaqësues me autorizim i znj. Almiva Llaçi, përfaqësuese e Bashkisë Durrës:
Po.

Z. I. Celibashi: Thatë në mos gaboj, që nuk keni mundur që ta sqaroni sepse...

Përfaqësues me autorizim i znj. Almiva Llaçi, përfaqësuese e Bashkisë Durrës:
Po, ka patur problem me aksesimin, të paktën nga personi që është i ngarkuar nga institucioni.


Z. I. Celibashi: Kur vendosët që ta shvilloni këtë veprimtarinë?

Përfaqësues me autorizim i znj. Almiva Llaçi, përfaqësuese e Bashkisë Durrës:
Rreth 4-5 ditë përpara.

Z. I. Celibashi: 4-5 ditë para është dallim shumë i madh. Nëse është 4 ditë para jeni në shkelje të ligjit, nëse është 5 ditë...

Përfaqësues me autorizim i znj. Almiva Llaçi, përfaqësuese e Bashkisë Durrës:
Nuk kemi pamje as të Kryetarit të Bashkisë, as prononcim elektoral, as të ketë filmim apo foto të Kryetarit të Bashkisë.

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.01.02.2023*

Z. I. Celibashi: Diskutimi nuk është në lidhje me sjelljen dhe përmbajtjen e veprimtarisë sepse nuk ka patur askush asnjë pretendim në lidhje me veprimtarinë. Pretendimi është për raportimin në afat ose jo. Sipas të dhenave që ne si institucion disponojmë rezulton që këto veprimtari nuk janë raportuar sipas parashikimeve të ligjit. Nga ana tjetër, për ju dhe për të gjithë të tjerët të ngjashëm si ju, në kuptimin institucional, qendror ose jo të tillë, ligji nuk ka asnjë ndalim që qoftë kryetari i bashkisë, qoftë një ministër apo një funksionar tjetër publik të zhvillojë veprimtarinë e vet, në përputhje me parashikimet e ligjit që e ka ngarkuar atë për ta ushtruar atë funksion. Ndalimet janë që gjatë zhvillimit të kësaj veprimtarie mos të ketë nuancë të aktivitetit politik dhe elektoral. Nëse një kryetar bashkie do ti duhet të bëjë vlerësimin e një objekti të punës së vet material ose jo material, ai është i lirë ta bëjë këtë, por pa kaluar atë kufirin që pastaj e klasifikon si veprimtari politike dhe elektorale. Kështu që edhe në rastin konkret nuk ka asnjë arsye që Kryetari i Bashkisë Durrës, por dhe kushdo tjetër funksionar publik të ketë ndrojtje për tu shfaqur publikisht kur thjesht dhe vetëm janë duke bërë punën e tyre, duke kryer funksionet e tyre, për të cilat janë ngarkuar nga ligji. Ndalimi është nëse këto veprimtari, sikurse thashë edhe në nuancën e tyre mundet të na tregojnë sikur janë veprimtari politike dhe elektorale.

Përfaqësues me autorizim i znj. Almiva Llaçi, përfaqësuese e Bashkisë Durrës:
Në fakt këto nuk janë veprimtari elektorale dhe politike, janë thjesht zbatimi i detyrave dhe i funksioneve të kryetarit të bashkisë.

Z. I. Celibashi: Mirë, kemi ndonjë informacion më shumë në aspektin teknik, lidhur me pretendimin që nuk është aksesuar ndërfaqja?

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.01.02.2023*

Znj. M. Koja: Jo nuk kemi informacion.

Z. I. Celibashi: Në kohën që... ekzistojnë komunikimet për hapjen e llogarive, në rastin konkret dhe të Bashkisë Durrës. Mirë faleminderit, faleminderit dhe juve! Institucion tjetër ju lutem!

Znj. Raimonda Shuka, përfaqësuese e Bashkisë Dimal: Përshëndetje, Raimonda Shuka, Sekretare e Përgjithshme e Bashkisë Dimal. Nga ana juaj është dërguar një shkresë në lidhje me mosraportimin e veprimtarive me karakter publik jo brenda afatit të duhur. Në lidhje me shkresën tuaj sqarojmë se raportimi është bërë në datën 23.01.2023 dhe zhvillimi i veprimtarisë është bërë në datën 27.01.2023. Ka qenë një aktivitet me fokus ndërgjegjësimin në lidhje me mbjelljen e pemëve, por zhvillimi i këtij aktiviteti në këtë afat ligjor dhe tërheqja e vëmendjes nga ana juaj ka ardhur si pasojë e mosinterpretimit të drejtë të afateve ligjore. Këtu qendron e gjithë çështja, sepse është menduar se data e pestë, dita e premte përkon tamam me ditën e llogaritjes sipas afateve kalendarike. Është thjesht një lapsus nga ana e institucionit, e cila është treguar edhe më tej me raportimin e aktivitetit, i cili duhet të zhvillohej ditën e premte. Pra ne përsëri kemi raportuar aktivitetin që do të zhvillohej në datën 3 shkurt. Me marrjen e shkresës suaj dhe pas sqarimeve përkatëse dhe pas konsultimeve, ne e kemi rregulluar këtë procedurë, duke filluar raportimet e sakta, që prej ditës së djeshme, por gjithmonë ngelemi me idenë që nuk ka patur asnjë moment nga ana e institucionit tonë, dëshirë për të raportuar përpara periudhës së caktuar nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Institucioni jonë ngelet në gadishmëri dhe ka përgjegjësinë ligjore dhe do të raportojë në afatet e përcaktuara, jo më vonë se 5 ditë përpara zhvillimit të veprimtarive, faleminderit.

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.01.02.2023*

Z. I. Celibashi: Faleminderit edhe ju! Ju tani për momentin keni problem me aksesin e ndërfaqes?

Znj. Raimonda Shuka, përfaqësuese e Bashkisë Dimal: Jo, tani nuk kemi probleme.

Z. I. Celibashi: Faleminderit, po drejtoresha!

Znj. M. Koja: Më falni zoti Komisioner, keqkuptimi që sapo na dha Sekretari i Përgjithshëm i Bashkisë Dimal, ka ndodhur edhe në institucione të tjera. Llogaritja e afatit 5 ditor, ku 5 ditë janë në dispozicion të KQZ-së për të marrë vendimin e tij, për të ndaluar apo jo veprimtarinë. Pra, me kalimin e 5 ditëve nga dita e raportimit, nga e nesërmja mund të zhvillohet veprimtaria. Jo më vonë se 5 ditë thotë ligji. Është një kufi minimal në funksion të KQZ-së. Ky keqkuptim nuk është vetëm për Bashkinë Dimal. Më mirë që u ngrit si diskutim që ta themi edhe për të gjitha institucionet në vazhdim. Këto 5 ditë janë në dispozicion të KQZ-së. Me kalimin e këtyre 5 ditëve, nga e nesërmja, mund të zhvillohen veprimtarinë.

Z. I. Celibashi: Dakord, mendoj se është e qartë. Është thjesht çështje matematike, 5 ditë para zhvillimit të aktivitetit, do të thotë që janë 5 ditë të plota përpara datës. Data kur zhvillohet aktiviteti nuk duhet të përfshihet. Aktiviteti do të duhet të zhvillohet ditën e 6. Mirë faleminderit, tjetër institucion?

Z. Bajram Pishkashi, përfaqësues i Bashkisë Librazhd: Përshëndetje, Bajram Pishkashi, Sekretar i Përgjithshëm, Bashkia Librazhd. Në datën 28 me shkresë

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.01.02.2023*

përcjellëse nga ana juaj, 28.01.2023 dhe protokoll hyrës 30.01.2023 kemi marrë njoftimin për kërkesë për paraqitje në procesin administrativ, domethënë ditën e pardjeshme dhe kemi nisur me email dhe me postë zyrtare kthimpërgjigjen , por duke qenë se në shkresë njoftoheshim se duhej të ishim present edhe për seancën publike, menduam që të bëhemi pjesë e seancës për të dhënë shjegimet verbalisht. Aktiviteti është raportuar në 23.01.2023 dhe është zhvilluar në 26.01.2023, pra sipas llogaritjeve tona 4 ditë para. Data 23 ka përkuar ditë e hënë dhe për këtë arsye është bërë në 23 nga ana ime dhe aktiviteti ishte parashikuar të zhvillohej në datën 26 nga Kryetari i Bashkisë. Objekti i aktivitetit ka qenë inspektimi i punimeve ne një shkollë që po kryhej nga donator të huaj, me fonde të huaja. Në një shkollë të vogël në një fshat të Librazhdit. Nuk ka pasur fokus politik, por thjesht Kryetari i Bashkisë ka bërë inspektim punimesh me drejtuesit teknik të subjektit ndërtues dhe me Administratorin e njësisë Administrative.

Z. I. Celibashi: Nuk e kemi këtë pretendim nga askush në lidhje me natyrën e aktivitetit. Pretedimi është vetëm në lidhje me afatin.

Z. Bajram Pishkashi, përfaqësues i Bashkisë Librazhd: Për sa i përket aksesit, sipas printshkrimeve që ka bërë nga emaili im zyrtar unë jam loguar në datën 13.01.2023. Më kanë ardhur kredencialet. Në datën 16.01.2023 kam bërë logimin duke hapur dhe llogarinë në faqen zyrtare. Domethënë ka qenë disa ditë para. Për shkak dhe të vështirësive dhe të ngarkesës së madhe të punës, vështirësive për të aksesuar, ka dashur kohën e vet, Unë ndoshta jam gabim në llogaritjen e fateve, me 1 ditë sipas llogarive tona. Nga diskutimi që bëtë paraprakisht kuptova që duhet të ishin 5 ditë të plota, kështu që në aktivitetet e rradhës do të mundohemi të jemi

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.01.02.2023*

korrekt me 5 ditëshin e plotë. Është bërë gjithçka pa ndonjë qëllim dashakeq ose për të keqinformuar.

Z. I. Celibashi: Këtë e besoj, faleminderit! Ka ndonjë përfaqësues të ndonjë institucioni tjetër?

Znj. Erisa Gjalliu, Përfaqësuese e Bashkisë Lushnje: Përshëndetje, unë jam Erisa Gjalliu, Drejtor i Burimeve Njerëzore, Bashkia Lushnje. E kam dërguar edhe me shkresë mbrojtjen time. Është e njëjta gjë si më kolegen e Bashkisë Dimal. E kam llogaritur 5 ditë duke përfshirë edhe ditën e aktivitetit. Ka qënë inspektim punimesh në një fshat, në Barbullinjë, të Bashkisë Lushnje. E kam raportuar 21 për 25, me idenë që 25-a është ditë që përfshihet në raportim. Kam patur problem me aksesimin në system deri vonë, ndërsa tai jam në rregull.

Z. I. Celibashi: Tani nuk keni më problem me aksesimin.

Znj. Erisa Gjalliu, Përfaqësuese e Bashkisë Lushnje: Jo, e sqaruar dhe për pjesën e afatit, ishte një lapsus i paqëllimshëm.

Z. I. Celibashi: Mirë, faleminderit!

Znj. Erisa Gjalliu, Përfaqësuese e Bashkisë Lushnje: Faleminderit ju!

Z. I. Celibashi: Institucion tjetër, ka ndonjë institucion tjetër që është prezent? Nuk ka. Po, fjala është për ju.

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.01.02.2023*

Znj. Erjola, përfaqësuese e Ministrisë së Kulturës: Përshëndetje, jam Erjola, përfaqësoj Ministrinë e Kulturës. Pretendimet në fakt janë dërguar edhe me shkrim. Siç keni sqaruar, dy aktivitetet nuk kanë qenë veprimtari me karakter publik dhe Ministria e Kulturës ka patur statusin e të ftuarit. Nuk ka patur mundësi objektive për të njoftuar, pasi ftesa ka ardhur sot dhe aktiviteti ka qenë ditën e nesërme. Pra, dy nga aktivitetet, ndërsa për sa i përket aktivitetit të tretë, prezantimi i drejtorit, aktiviteti është kryer në kuadër të organizimit të brendshëm midis Ministrisë dhe institucioneve të saj të varësisë. Për shkak të axhendës së ngjeshur të zonjës ministre aktiviteti është caktuar në një datë të mëparshme dhe nuk ka patur karakter publik, te ftuar jashtë institucioneve.

Z. I. Celibashi: Por ka qenë me praninë e medias?

Znj. Erjola, përfaqësuese e Ministrisë së Kulturës: Po ka patur media sepse vendi i drejtorit ka qenë vakant prej një kohe të gjatë. Është njoftuar shpallja e vakancës në media dhe për shkak të rëndësisë që mbart si vend, ka patur media, por jo të ftuar.

Z. I. Celibashi: Po kuptova, ndërsa për dy aktivitetet e tjera thatë që nuk keni qenë ju organizatori, por keni qenë të ftuar.

Znj. Erjola, përfaqësuese e Ministrisë së Kulturës: Po.

Z. I. Celibashi: Dakord, faleminderit! Institucione të tjera të cilat janë prezent duan të japin shpjegime? Nuk ka, mirë falemnderit. Atëherë edhe njëherë Madalena të

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.01.02.2023*

lutem, nga 6 institucionet që nuk kanë dhënë shpjegime me shkrim përfshiheshin, Bashkia Durrës, Bashkia Dimal dhe Bashkia Librazhd?

Znj. M. Koja: Jo, Bashkia Lushnje ka dhënë shpjegime, edhe Ministria e Kulturës gjithashtu ka dhënë shpjegime, ndërsa Bashkia Durrës, Bashkia Dimal nuk kishin dhënë shpjegime. Këto dhe institucione të tjera për të cilat do i marrim vendimet duke i bërë pyetje në seancën e rradhës, duke vlerësuar dhe pretendimet e sotme.

Z. I. Celibashi: Ministria e Turizmit dhe...

Znj. M. Koja: Bashkia Berat konstatuar nga ana jonë. Kanë dhënë shpjegime, por në vlerësimin tonë nuk qëndrojnë.

Z. I. Celibashi: Nuk kanë respektuar afatet për raportimin.

Znj. M. Koja: Jo, nuk e kanë respektuar dhe argumenti i dhënë është që planifikimi nuk është bërë në periudhën përpara, pra planifikuar nga sot për nesër nga ana e titullarëve dhe kjo ka çuar në pamudësi për të raportuar në kohë. Gjë që në 4 muaj para zgjedhjeve veprimtaritë publike të institucioneve duhet të disiplinohen ndryshe sipas procedurës së kodit zgjedhor.

Z. I. Celibashi: Mirë faleminderit! Do të procedojmë pastaj me vlerësimin e pretendimeve, si ato të dhëna me shkrim dhe ato të dhëna sot nga përfaqësuesit e institucioneve dhe nëse do të jetë rasti do të sanksionojmë personat përgjegjës për raportimin, nëse do të besojmë që janë shkelje të dispozitave të Kodit Zgjedhor lidhur me afatin e raportimit, por gjithsesi përtej kësaj, do të doja ta theksoja publikisht që më vjen mirë që janë përgjigjur pjesa më e madhe e institucioneve, jo vetëm KQZ-së në kuptimin e marrëdhënies institucionale, të reflektuar ndaj kërkesave të KQZ-së, por edhe në tërësi në lidhje me zbatimin e Kodit Zgjedhor

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.01.02.2023*

dhe vendimit nr. 9 për raportimin e veprimtarive publike. Faleminderit atyre që ishin sot prezent dhe prezantuan direkt përpara nesh pretendimet e tyre. E mbyllim seancën publike, faleminderit të gjithëve!

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*

